

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies, zhvilloi një trajnim me temë: "Standartet profesionale të mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e studentëve me standartet profesionale të mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi ndryshe, të cilat përshkruajnë atë që pritet të njohë, të kuptojë, të zotërojnë dhe të demonstrojnë mësuesi ndihmës në procesin e edukimit dhe mbështetjes së zhvillimit të fëmijëve me aftësi ndryshe.

Trajnimi synoi të evidentojë sfidat kryesore të profesionit të mësuesit ndihmës.

